



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HAS

KËSHILLI

VENDIM

*Nr.135, Datë 23.12.2024.*

Për

**Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2025.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b", nenit 35, nenit 36 dhe nenit 54, pika 1, shkronja "F" të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetqeverisjen Vendore"; Ligjit nr.9632, date 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" (i ndyshuar); nenit 128 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë" (i ndyshuar); Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të nenit 2, pika 3, të VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", VKM nr.408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit".

Këshilli Bashkiak Has në mbledhjen e dates **23 /12/2024** me :

**13 Vota Pro**

**0 Vota Kundër**

**0 Abstenim**

VENDOSI:

**1.Të miratojë sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2025.**

## Përmbajtja e vendimit.

### “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2025”

1. Krijimi i zonave fiskale në territorin e Bashkisë Has.
2. Tarifa për zënien e hapsirave publike.
  - a. Tarifa e tregut të lirë (zënies së hapësirës publike)
  - b. Tarifa e shërbimit veterinarë
3. Taksa e tabelës për personat fizikë dhe juridikë.
4. Taksa mbi pasuritë e paluajtshme (taksa e ndërtesës).
  - a. Taksa mbi ndërtesën
  - b. Taksa mbi tokën Bujqësore
  - c. Taksa mbi truallin
5. Taksa e ndikimit në infrastrukturë.
6. Tarifa e pastrimit për familjarët dhe personat fizikë e juridikë.
7. Tarifa e gjelbër.
8. Tarifë shërbimi për procedurë kalimi pronësisë paluajtshme
9. Tarifa për aktet që lëshohen nga institucioni i Bashkisë e të tjera.
10. Tarifa të sektorit të Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit.
11. Tarifa e ndriçimit të rrugëve dhe shesheve të qytetit.
12. Tarifa për parkimin e automjeteve në vendet e parkimit publik.
13. Tarifa e reklamës.
14. Tarifa të ndryshme.
15. Tarifa për gjobat dhe kundravajtjet administrative.

## 1. KRIJIMI I ZONAVE FISKALE NË TERRITORIN E BASHKISË HAS

Në përputhje me organizimin administrativ dhe urbanistik në territorin e Bashkisë Has, për të ndarë proporcionalisht nivelin e taksave dhe tarifave që aplikon Bashkia ndaj subjekteve të ndryshëm, krijohen këto zona fiskale:

1. Zona "A" : Qyteti Krumë.
2. Zona " B ": Njësitë Administrative Golaj, Fajza, Gjinaj dhe fshatrat e Njësisë Adm Krumë.

## 2. TARIFA PËR ZËNIEN E HAPSIRAVE PUBLIKE

### a. Tarifa e tregut të lirë (zënies së hapësirës publike)

Nr.	Lloji i aktivitetit	Tarifa në lekë/muaj për m <sup>2</sup>	
		Viti 2024	Viti 2025
1	Merkatoja (tregu i lirë publik)	120 lekë/m <sup>2</sup>	120 lekë/m <sup>2</sup>
2	Kioskat (tregu i lirë publik)	100 lekë/m <sup>2</sup>	100 lekë/m <sup>2</sup>
3	Për zënie hapsire publike për tregti (vendosje tavolinash, mallra jashtë vendit të tregtimit)	50 lekë/m <sup>2</sup>	50 lekë/m <sup>2</sup>
4	Të gjitha aktivitetet e tjera të zënies së hapësirës publike për nevoja biznesi në Zonën "A"	150 lekë/m <sup>2</sup>	150 lekë/m <sup>2</sup>
5	Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi nga subjektet minerare, guroreve, të ndërtimit dhe të ngjashme me to në Zonën "B"	200 lekë/ m <sup>2</sup> /vit	200 lekë/ m <sup>2</sup> /vit

Baza e taksës është Siperfaqja në metër katror e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

### Lehtësira dhe përjashtime.

Për Merkaton (tregu i lirë publik) që lidhin kontratë me afat 12 mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes, përfitojnë 10% zbritje të detyrimit.

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.*

### b. Tarifa e shërbimit veterinarë

Tarifa është detyrim fiks që aplikohet nga shërbimi veterinar për të gjithë kategoritë e subjekteve apo individeve që kanë aktivitet me thertoren me pikën e therjes apo tregun e gjësë së gjallë.

	Kategoritë e aktivitetit të kontrollit	Kontrolli	Tarifa për çdo bagëti të therur
1	Kontrolli i mishit dhe paisja me raport veterinar për kre për bagëti të <b>Trasha</b>	Kontrolli mbi gjendjen e kafshës para, gjatë dhe pas therjes. Vulosja dhe plotësimi i dokumentacionit.	<b>500 Lekë</b> (për çdo kre)
2	Kontrolli i mishit dhe paisja me raport veterinar për kre për bagëti të <b>Imëta</b>	Kontrolli mbi gjendjen e kafshës para, gjatë dhe pas therjes. Vulosja dhe plotësimi i dokumentacionit.	<b>200 Lekë</b> (për çdo kre)

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.*

### 3. TAKSA E TABELËS PËR PERSONA FIZIKË DHE JURIDIKË

Bashkëngjitur tabela për përcaktimin e kësaj takse

Aneksi 7 sipas nenit 8 ligjit nr.106/2017, për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", Të Ndryshuar.

Taksa e Tabelës

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matese	Bashkia Has
<b>I.</b>	<b>Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupezuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)</b>		
<b>a</b>	<b>deri në 2 m2</b>	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	0
<b>b</b>	<b>-mbi 2m2 deri 10m2</b>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	7,000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	11,500
	-elektronike	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	15,000
<b>c</b>	<b>mbi 10 m2 deri 20 m2</b>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	5,950
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	9,775
	-elektronike	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	12,750
<b>ç</b>	<b>mbi 20m2 deri 40 m2</b>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	3,850
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	6,325
	-elektronike	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	8,250
<b>d</b>	<b>mbi 40 m2</b>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	2,800
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	4,600
	-elektronike	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	6,000
<b>II.</b>	<b>Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe permasat e tabelave për orientim</b>		
	<i>-Tabele identifikuese</i>	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	120
<b>III.</b>	<b>Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizeshme deri në tavanin maksimal 35 m2</b>		
	-e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	13,500
	-Elektronike	lekë/ m <sup>2</sup> /vit	27,000
<b>IV.</b>	<b>Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.</b>		
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/ m <sup>2</sup> /dite	1,000

### 4. TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTËSHME

#### 4.a TAKSA MBI NDËRTESEN

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Për efekt të llogaritjes së kësaj takse bazuar edhe në nenin 2, pika 3, të VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës", I ndryshuar URDHËR Nr. 1052, datë 2.12.2024 PËR MIRATIMIN E MESATARES SË ÇMIMEVE TË SHITJES SË BANESAVE NË TREG, SIPAS ZONAVE KADASTRALE, PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE .

**Miratoi nëndarjen zonale/nënzonale të territorit të Bashkisë Has dhe cmimin mesatar referues të banesave për vitin 2025 sipas këtyre ndarjeve si më poshtë vijon:**

**4.a.1.** Miratimin e ndarjeve të zonave/nënzonave të territorit të Bashkisë Has si në tabelën nr. 1 më poshtë:

**Tabela nr.1 e ndarjes së zonave/nënzonave**

Ndarja ne ZONA		Ndarja në NËNZONA	
1	Qyteti KRUMË	1	Fshatrat: CAHAN; MUJAJ; KISHAJ; ZAHRIŠHT; GAJREP; KRUMË.
		2	Njësia Administrative GOLAJ
		3	Njësia Administrative FAJZA
		4	Njësia Administrative GJINAJ

**4.a.2.** Miratimin e shkallës së taksës si në tabelën nr.2 më poshtë:

**Tabela nr. 2 e përcaktimit të shkallës së taksës**

Lloji i Ndërtesave	SHKALLA E TAKSËS	
	Për ZONAT e Bashkisë Has	Për NËNZONAT e Bashkisë Has
a. Ndërtesë që përdoret, shfrytëzohet për banim	0.035%	0.035%
b. Ndërtesë që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike	0.2%	0.2%
c. Për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi	30% e shkallës së taksës përkatëse	30% e shkallës së taksës përkatëse

Për zonat dhe nënzonat e Bashkisë Has kemi një ulje të shkallës së taksës në masën 30% për banesat.

**4.a.3.** Miratimin e cmimit mesatar referues për vitin 2025 të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi sipas tabelës nr. 3, më poshtë.

**Tabela nr. 3 e përcaktimit të cmimit mesatar referues të banesave për vitin 2025**

Qyteti	Lekë/ m <sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi	Njësitë Administrative nënzonat e Bashkisë Has	Lekë/ m <sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi		
1	KRUMË	36,000 Lekë	1	Njësia Administrative GOLAJ	23,400 Lekë
			2	Njësia Administrative FAJZA	
			3	Njësia Administrative GJINAJ	
			4	Fshatrat: CAHAN; MUJAJ; KISHAJ; ZAHRIŠHT; GAJREP; KRUMË.	

Për njësitë administrative të Bashkisë Has dhe nënzonat ka një ulje 0,65% të cmimit mesatar referues të banesave për vitin 2025.

Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndyshuar, cmimi për m<sup>2</sup> është 70% e cmimit sipas tabelës nr 3, vetëm në rastin e shitjes së parë.

Taksa mbi ndërtesën llogaritet si detyrim vjetor i tatimpaguesve.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

**Përrjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**

- a) Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike
- b) Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë.
- c) Si dhe ndërtesat e percaktuara sipas nenit 22, pika 6, te Ligjit nr. 9632, date 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" (i ndyshuar).

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Sektori i Taksave dhe Tarifave, si dhe Sektori i Urbanistikës pranë Bashkisë Has në bashkëpunim me njësitë administrative.*

**4.b. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE**

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektarë, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve të pronësisë. Në rast të mungesës së dokumenteve të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë Bashkisë Has.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektarë. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e taksueshme.

**Niveli i taksës, është si vijon:**

<b>Klasifikimi i kategorisë së tokës bujqësore nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë</b>	<b>Lekë/hektarë/vit</b>
VII - X	700

**Lehtësira dhe përjashtime.**

- Përrjashtohen nga taksa , tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë-vitet-e-para-nga-çasti-i-mbjelljes.

**4.c. TAKSA MBI TRUALLIN**

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katrorë, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katrorë. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e taksueshme. Nivelet treguese të taksës, për cdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në tabelën e mëposhtëme.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë , përdoruesi i truallit bën një vetdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

**Niveli i taksës së truallit (jo hapsirë publike) , është si vijon:**

	<b>Vlera e Taksës në lekë/ m<sup>2</sup>/vit për qëllime banimi nga individët</b>	<b>Vlera e Taksës në lekë/ m<sup>2</sup>/vit për qëllime biznesi</b>
<b>Bashkia Has</b>	0.14 lekë/ m <sup>2</sup> /vit	12 lekë/ m <sup>2</sup> /vit

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.*

## **5. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURË**

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e cmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

**Niveli i taksës, është si vijon:**

1. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorimit publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4% e çmimit të shitjes/m<sup>2</sup>. Çmimi i shitjes/m<sup>2</sup> bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtarë i Banesave që miratohet çdo vit.
2. Në rastin e ndërtimeve të ndyshme nga ato të pikës 1, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe për Bashkinë Has është **1 (një) % (per qindë)**.
3. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
4. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 % e vlerës së investimit.

*Ngarkohet Sektori i Urbanistikës për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe të ardhurat arkëtohen nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore pranë Bashkisë Has.*

## **6. TARIFA E PASTRIMIT PËR FAMILJARËT DHE PERSONAT FIZIKË E JURIDIKË**

### *Tarifa në lekë/vit*

Nr	Emërtimi i subjektit	2024	2025
1	<b>Familjarët (për familje)</b>	1.000	1.000
2	<b>Shitoret për fruta, perime, ushqimore, bulmetore me sipërfaqe lokali :</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	9.500	9.500
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	12.500	12.500
3	<b>Shitoret për mish, peshk me sipërfaqe lokali :</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	10.500	10.500
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	13.000	13.000
4	<b>Lokalet bar-bufe, restorante me sipërfaqe lokali:</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	11.000	11.000
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	13.000	13.000
5	<b>Shitoret e artikujve të përzier dhe industrialë me sipërfaqe lokali:</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	12.000	12.000
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	12.500	12.500

6	Institucionet social kulturore private për çdo njësi të liçencuar.	13.000	13.000
7	Njësi shërbimi, riparime, punime artizanale, rrobaqepësi, servise, lavazhe, parkingje, bilardo, fotograf të biznesit të vogël.	5.500	5.500
8	Njësi shërbimi e riparimi (teneqepunues, zdrukhtari, radio, riparim telefonash, berber, floktore, taksi etj).	6.500	6.500
9	Shërbimet e specializuara: Dentist, farmaci, farmaci bujqësore, radiolog, shërbime interneti, ekografist, laborator, biznes i vogël	14.000	14.000
10	Shërbimetë tjera si: Avokat, noter, kancelarie, fotokopje, librari, shtypshkronjë, kafe internet, Njësi transferta parash apo këmbime valutore.	6.000	6.000
11	Njësi prodhimi (druri, duralumini, parafabrikate ndërtimi, furra buke, ëmbëltore, byrektore etj.)	9.000	9.000
12	Biznesi i vogël që klasifikohet me T.V.SH	17.000	17.000
13	Të gjithë personat juridikë të biznesit të madh, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe.	40.000	40.000
14	Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj.	40.000	40.000
15	Firmat e tregtimit të karburanteve dhe të gazit.	45.000	45.000
16	Kompanitë celulare apo të komunikimeve elektronike dhe të lidhura me to.	50.000	50.000
17	Subjektet me aktivitet minerar dhe hidrocentralet pamvarësisht zonës A apo B.	120.000	120.000
18	Subjektet me aktivitet në fushën e inerteve (guoret) dhe fabrikat pamvarësisht zonës A apo B.	50.000	50.000
19	Institucionet social kulturore dhe shtetërore që përdorin Pallatin e Kultures. Jo me pak se 3 ore Takimi që rezervohet .	5.000 Çdo takim	5.000 per 1 ore Pa foni.
	Perdorimi i fonise se Pallatit te kultures ne rastet kur kerkohet do te jete :		10.000 Per cdo takim
20	Të gjithë personat që klasifikohen si ambulantë.	2.500	2.500
21	Transport Pasagjerësh dhe mallrash subjekte juridike te biznesit të madh.	20.000	20.000
22	Transport Pasagjeresh dhe mallrash subjekte persona fizik dhe individe për nevoja të veta.	3.000	3.000

### Lehtësira dhe përjashtime.

Niveli i tarifës për familjarët e Nj/Adm Gjinaj, përfshirë fshatrat Cahan, Kishaj, Mujaj është **500 Lekë/vit.**

Niveli i tarifës për familjarët përfitues të ndihmës ekonomike është **650 Lekë/vit.**

Përjashtohen nga taksa familjare e pastrimit Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhore (mbi 22 vjeç) në ngarkim.

Niveli i tarifës për bizneset sipas zonave: Zona "A" 100%

Zona "B" 80%

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Ujesjellës-Kanalizimeve pranë Bashkisë Has (sipas udhëzimeve të*

*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*



nxjerra nga Kryetari i Bashkise Has për këtë agjent tatimor), sektorë të tjerë dhe njësitë administrative.

## 7. TARIFA E GJELBËR

Tarifa në lekë/vit

Nr	Emërtimi i subjektit	2024	2025
1	Familjarët	0	0
2	<b>Shitoret për fruta, perime, ushqimore, bulmetore me sipërfaqe lokali :</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	800	800
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	1.000	1.000
3	<b>Shitoret për mish, peshk me sipërfaqe lokali :</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	600	600
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	700	700
4	<b>Lokalet bar-bufe, restorante me sipërfaqe lokali :</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	700	700
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	1.000	1.000
5	<b>Shitoret e artikujve të përzier dhe industriale me sipërfaqe lokali :</b>		
	a. deri në 50m <sup>2</sup>	750	750
	b. mbi 50 m <sup>2</sup>	1.000	1.000
6	<b>Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj dhe institucionet social kulturore private.</b>	3.000	3.000
7	<b>Njësi shërbimi, riparime, punime artizanale, rrobaqepësi, servise, lavazhe, parkingje, bilardo, fotograf të biznesit të vogël.</b>	500	500
8	<b>Njësi shërbimi e riparimi (teneqepunues, zdruckhtari, radio, riparim telefonash, berber, floktore, taksi etj.)</b>	500	500
9	<b>Shërbimet e specializuara : Dentist, farmaci, farmaci bujqësore, radiolog, shërbime interneti, ekografist, laborator.</b>	2.500	2.500
10	<b>Shërbime të tjera si: Avokat, noter, kancelarie, fotokopje, librari, shtypshkronjë, kafe internet, Njësi transfertarësh apo këmbime valutore.</b>	500	500
11	<b>Njësi prodhimi (druri, duralumini, parafabrikate ndërtimi, furra buke, ëmbëltoje, byrektore etj.)</b>	600	600
12	<b>Biznes i vogël që klasifikohet me T.V.Sh.</b>	2.500	2.500
13	<b>Të gjithë personat juridikë të biznesit të madh, dhe sh.a –të, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe.</b>	3.000	3.000
14	<b>Kompanitë celulare apo të komunikimeve elektronike dhe të lidhura me to</b>	4.000	4.000
15	<b>Firmat e ndërtimit dhe të lidhura me to.</b>	2.500	2.500
16	<b>Firmat e tregtimit të karburanteve dhe të gazit</b>	2.500	2.500
17	<b>Subjektet me aktivitet minerar, hidrocentraleve, inerteve (guroret) dhe fabrikat pamvaresisht zones A apo B.</b>	3.000	3.000
18	<b>Të gjithë personat që klasifikohen</b>	300	300

	<b>si ambulantë</b>		
19	<b>Transporte te licensuara, shpk, biznes i madh</b>	2.000	2.000

Niveli i tarifës sipas zonave: Zona "A" 100%  
Zona "B" 80%

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.

## **8. TARIFA E SHËRBIMIT PËR PROCEDURËN E KALIMIT TË PRONËSISË**

Bazuar ne VKM nr. 608, datë 5.9.2012 si dhe dhe në VKM nr. 812, datë 16.11.2016 " Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për rregjistrimin e tyre", Tarifa e shërbimit për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme , të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohet akt fitimi pronësie nga institucioni i autorizuar Bashkia Has si dhe për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP Has të jetë si më poshtë:

**Tarifë shërbimi me vlerë 5,000 (pesë mijë) Lekë.**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Urbanistikës dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore pranë Bashkisë Has.

## **9. TARIFAT PËR AKTET QË LËSHOHEN NGA INSTITUCIONI I BASHKISË**

Tarifa në lekë

Nr.	Lloji i aktit	2024	2025
1	Vërtetim për marrëdhënie pune me Bashkinë	50	50
<del>2</del>	<del>Vërtetim për mostrajtim me ndihmë ekonomike</del>	<del>50</del>	<del>50</del>
3	Vërtetim për shlyerje detyrimi Perjashtuar per personat qe trajtohen me ndihmë ekonomike	50	50
4	Autorizim pensioni	100	100
5	Vërtetim për pronësi toke	50	50
6	Vërtetim për njohje sheshi ndërtimi	100	100
7	Vërtetim për llogari personi	100	100
8	Leje për shfrytëzim objekti	2.000	2.000
9	Tarifë shërbimi kalim pronësie para datës 10.08.1991	150 leke m <sup>2</sup>	150 leke m <sup>2</sup>
10	Tarifë Gent Plan (plan vendosje)	500	500

## **10. TARIFA TË SEKTORIT TË URBANISTIKËS DHE PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT PËR VIITIN 2025**

Tarifat e shqyrtimit të praktikave për leje zhvillimi, ndërtimi, mirëmbajtje, certifikatë përdorimi, akte kontrolli si detyrime që rrjedhin nga Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" si dhe VKM-se nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" me ndyshimet përkatëse, si dhe funksionimit të sistemit elektronik të e-lejeve, janë si në tabelën më poshtë

Tarifat e shërbimeve të Sektorit të Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit për vitin 2025

Nr.	Shërbimi	Vlera e Tarifës në Lekë
1	Tarifë për shqyrtim kërkesë Leje Zhvillimi.	5'000
2	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi të ri për sipërfaqe më të madhe se 250 m2 që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	10'000
3	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për ndërtim të ri për sipërfaqe deri 250m2 që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	5'000
4	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues për sipërfaqe më të madhe se 250 m2 që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	10'000
5	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues për sip. deri 250 m2 që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	5'000
6	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues	10'000
7	Tarifë për shqyrtim kërkesë për mirëmbajtje të zakonshme, në momentin e aplikimit.	0
8	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni, që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	5'000
9	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	5'000
10	Tarifë për shqyrtim Deklaratë paraprake punimesh që në momentin e dorëzimit të kërkesës për pajisje me deklarate.	0
11	Tarifë për shqyrtim Leje për shtyrjen e afatit të lejes	5'000
12	Tarifë për Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit.	0
13	Tarifë për shqyrtim Leje për ndryshimin e funksionit/aktiviteteve.	5'000
14	Akt kontroll karabina, sistemim i jashtëm për objekte mbi 3 kate	1'500 për akt
15	Tarifë për shkresë përcjellëse (Aluizni, ZRPP, AKKP etj.).	0
16	Shqyrtim për pajisje me çertifikate përdorimi.	5'000
17	Tarifë për çertifikatë përdorimi për objekte industriale, për volumin e objektit të ndërtuar.	50 lekë/m3
18	Tarifë për çertifikatë përdorimi për shtëpi-banimi, dhe ndërtime apo ambiente shërbimi për volumin e objektit të ndërtuar (jo industrial).	39 lekë/m3

Ngarkohet Sektori i Urbanistikës për përllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e këtyre tarifave dhe të ardhurat arkëtohen nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore pranë Bashkisë Has.

## 11. TARIFA E NDRICIMIT TË RRUGËVE DHE SHESHEVE TË QYTETIT

Tarifa në lekë/vit

Nr.	Emërtimi i subjektit	2024	2025
1	Të gjithë subjektet e biznesit të vogël.	2.500	2.500
2	Të gjithë subjektet e biznesit të madh.	4.000	4.000
3	Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj.	4.000	4.000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.

## 12. TARIFA PËR PARKIMIN E AUTOMJETEVE NË VENDET E PARKIMIT PUBLIK

Tarifa në lekë/24 orë

Nr.	Emërtimi i mjetit	2024	2025
1	Autoveturë	100	100
2	Mikrobuz	150	150
3	Autoveturë taks	100	100
4	Mikrobuz taks	150	150
5	Kamion deri në 2 ton	150	150

## 13. TARIFA E REKLAMËS

Tarifa në lekë/vit

Nr.	Emërtimi i Subjektit	2024	2025
1	Të gjithë personat juridikë dhe Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj.	5.000	5.000

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.*

## 14. Tarifa të ndryshme

### 1. Tarifë për ujin e pishëm

Fshatrat	Tarifa në vitin 2024	Tarifa për vitin 2025
Golaj	30 lekë/m <sup>3</sup> familjarët dhe 60 lekë/m <sup>3</sup> bizneset	30 lekë/m <sup>3</sup> familjarët dhe 60 lekë/m <sup>3</sup> bizneset
Nikoliq	30 lekë/m <sup>3</sup> familjarët dhe 60 lekë/m <sup>3</sup> bizneset	30 lekë/m <sup>3</sup> familjarët dhe 60 lekë/m <sup>3</sup> bizneset
Fajza	30 lekë/m <sup>3</sup> familjarët dhe 60 lekë/m <sup>3</sup> bizneset	30 lekë/m <sup>3</sup> familjarët dhe 60 lekë/m <sup>3</sup> bizneset

### 2. Tarifa për ujin e vaditjes

100 lekë /ora (për sasinë 10 litra për sekondë).

### 3. Miratimi i cmimit të biletave të transportit të udhëtarëve

#### a. Transporti me taks ( për çdo taks të liçensuar )

Krumë - Tiranë	900 lekë ( 4+1 dhe 6+1 )
Krumë - Durrës	900 lekë ( 4+1 dhe 6+1 )
Krumë - Kukës	200 lekë ( 4+1 dhe 6+1 )

#### b. Transporti brenda rrethit ( automjete 8+1 )

Krumë – Golaj	100 lekë	Krumë – Vlahen	100 lekë
Krumë – Helshan	200 lekë	Krumë – Letaj	150 lekë
Krumë – Kosturr	200 lekë	Krumë – Zahrishte	100 lekë

Krumë – Kishaj 200 lekë

Krumë – Vranisht 100 lekë

4. Tarifa për drutë e zjarrit

600 Lekë /m3

5. Kontrata e qerasë me Sigurimet Shoqërore Has

30.000 Lekë /muaj.

*Struktura e ngarkuar për vjeljen e këtyre tarifave është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has në bashkëpunim më njësitë administrative dhe Drejtorinë Pyjore.*

**15. Për “GJOBAT PËR DËMTIME NË RRJETIN RRUGOR, RRJETIN ELEKTRIK DHE HAPSIRAT E GJELBRA DHE PUBLIKE TË BASHKISË HAS, SI DHE METODA E VLERËSIMIT TË DËMIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 29, pika 4, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55, pika 2 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”; nenet 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485 datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); neni 15 i ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor” (i ndryshuar); neni 32, pika 7 dhe 8 të Rregullores Nr. 22 AKEP, datë 24.6.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve të kabllave urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrbane të komunikimeve elektronike” (e ndryshuar); neni 10, pika 3 e neni 12 i ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”;

1. Dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin rrugor të listuara si më poshtë dënohen me gjobë 3.000 Lekë.

- a. Dëmtim, çarje, ndotje rruge
- b. Bllokim rruge në masën
- c. Dëmtim, çarje, ndotje trotuari
- d. Dëmtim bordure
- e. Dëmtim, bllokim pusete, kunete
- f. Vjedhje kapaku pusete, zgarë.

2. Dëmtimet dhe /ose ndërhyrjet në rrjetin elektrik rrugor rrjetit të telefonisë fikse të listuara më poshtë dënohen me gjobë deri në masën 5,000 Lekë.

- a. Lidhjet e pamiratuara në kandelabrat apo rrjetit ajror
- b. Dëmtimi i shtyllave
- c. Dëmtimi i ndiçuesve
- d. Përdorimi i shtyllave si suport për montimin e rreklamave, kapjen e kabllave elektrike, telefonike, internet etj.
- e. Dëmtimin e traseve kabllore e linjave ajrore nga punimet që kryen pranë tyre me leje ose pa leje si dhe shkujla e shtyllave.
- f. Ndërhyrjet në kuadrot e komandimit.

3. Dëmtimet dhe /ose ndërhyrjet në rrjetin e ujësjellesit të listuara më poshtë dënohen me gjobë në masën 5,000 Lekë.

- a. Lidhjet e pamiratuara në tubacion
- b. Dëmtimi i pusetave
- c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje.

4. Dëmtimet dhe /ose ndërhyrjet në hapsirat e gjelbërta dënohen me gjobë 5,000 Lekë

- a. Dëmtim i hapsirës së gjelbërt
- b. Zënie e hapsirës së gjelbërt pa leje
- c. Dëmtim prerje pemësh
- d. Vendosje posterash pa leje
- e. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash pa leje

5. Gjoha të tjera:

- a. Zënia e hapsires publike nga automjetet dënohet me gjobë 1,000 lekë.
- b. Zënia e hapsires publike nga therjet e bagetive te trasha dënohet me gjobë 1,000 lekë
- c. Zënia e hapsires publike nga therjet e bagetive te imeta dënohet me gjobë 500 lekë
- d. Zënia e hapsires publike nga ndërtime dënohet me gjobë 1,000 lekë

6. Struktura përgjegjëse për shqyrtimin e kundravajtjeve dhe vendosjen e gjobës është Policia Bashkiake, Inspektori i Territorit dhe Sektori i Shërbimeve Komunale.

7. Nëse këto tre zyra konsatojnë shkaktim demi që vjen si pasojë e kundravajtjes vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ me vetë vendos shpërblimin e dëmit.

8. Përlllogaritja e dëmit të kryhet sipas kësaj formule:  $Dm = TSDm \times KRb$

TSDm= totali i sendeve të dëmtuara

KRb = kosto për kthimin në gjendjen e mëparëshme të sendit të demtuar

***Të ardhurat e realizuara nga gjokat dhe dëmshperblimet shkojnë në të ardhurat e Bashkisë Has. Policia Bashkiake dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave është struktura përgjegjëse për arkëtimin dhe ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.***

**Ngarkohen sektorët përkatës për zbatimin e këtij vendimi.**

**KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK**  
**Isuf SEFOLLI**

